





RAPORTI I PERFORMANCËS

2025

BASHKIA PUSTEC



BASHKIA PUSTEC

Ky botim mbështetet nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.

Pustec, 2026










Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



Sweden
Sverige

Fjalor Shpjegues.....	4
Qellimi I Raportit	8
Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë	8
Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë	10
SHERBIME PUBLIKE VENDORE	11
 Arsimi Paraniversitar.....	24
 Menaxhimi i Mbetjeve.....	30
 Mbrojtja nga zjarri.....	32
menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	34
 Administrimi i pyjeve dhe kullotave.....	36
 Mbrojtja Sociale.....	38
QEVERISJA E MIRE.....	42
 Burimet Njerëzore.....	42
 Transparenca.....	45
Barazia Gjinore	47
eu Integrimi në BE	48
MENAXHIMI FINANCIAR.....	51
Mbeshtetje Biznesi & Zhvillimi Ekonomik	54
Planifikimi strategjik.....	60
KONKLUZIONE.....	64

FJALOR SHPJEGUES

Disagregim

Është procesi i ndarjes së të dhënave sipas kategorive të veçanta (si gjinia, mosha, vendbanimi urban/rural, tipi i institucionit publik/privat etj.) me qëllim që të kuptohet më mirë shpërndarja dhe ndikimi i një shërbimi ose fenomeni. Disagregimi ndihmon për të evidentuar pabarazitë, për të krahasuar grupet e ndryshme dhe për të planifikuar politika apo ndërhyrje më të drejtuara dhe gjithëpërfshirëse.

Funksion

Është fusha e veprimtarisë, për të cilën njëësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore

Nën-Tregues

Një nën-tregues është një element më i detajuar i një treguesi kryesor, që shërben për ta shpërbërë dhe matur më saktësisht një aspekt të veçantë të tij. Nën-treguesit ndihmojnë në kuptimin më të thelluar të performancës, duke dhënë informacion të ndarë sipas gjinive, zonave gjeografike, llojit të shërbimit (publik/privat) apo kritereve të tjera të disagregimit.

Produkt

Një produkt i realizuar nga bashkia i referohet një të mirë materiale ose shërbimi që ofrohet nga bashkia, e cila është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit apo të mirës materiale. Bashkitë sipas ligjit janë përgjegjëse për ofrimin e një game të gjerë shërbimesh publike, si transporti, kanalizimi, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbetjeve, shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe asaj civile etj.

Qeverisja e Mirë

I referohet parimeve dhe praktikave që garantojnë funksionimin efikas, transparent, gjithëpërfshirës dhe të drejtë të një bashkie. Në këtë kuadër përfshihen elementë si transparenca publike, barazia gjinore, integrimi në BE, pjesëmarrja qytetare, profesionalizmi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i qëndrueshëm financiar.

Sistemi i Matjes së Performancës

Është mekanizmi kombëtar dhe vendor për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi ofrimin e shërbimeve nga bashkitë. Ky sistem përfshin një grup treguesish dhe nën-treguesish të standardizuar, që përdoren për të krahasuar performancën e bashkive, për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në evidencë.

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 33, çdo bashki është e detyruar të krijojë një sistem të brendshëm matjeje dhe raportimi mbi performancën e saj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, përdorimin e burimeve dhe realizimin e objektivave. Ky sistem vendor lidhet ngushtë me sistemin kombëtar, duke mundësuar harmonizimin e të dhënave dhe krahasimin mes njësisive të vetëqeverisjes vendore.

Sherbime Publike Vendore

Janë shërbimet që ofrohen nga bashkia për komunitetin, në përputhje me funksionet e përcaktuara nga ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Këto përfshijnë, ndër të tjera, , ndriçimin publik, arsimin parashkollor dhe cerdhet, mbrojtjen sociale, menaxhimin e mbetjeve, pyjeve e kullotave dhe ujitjen dhe kullimin etj. Sipas perkufizimit the ligjit "Janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme, sipas standardeve minimale kombëtare, të përcaktuara me ligj apo me akte të tjera normative'

Tregues performance

Një tregues i performancës është një matje që përdoret për të vlerësuar suksesin ose përparimin e një procesi. Mund të përdoret për të gjurmuar arritjet kryesore të performancës, të tilla si performanca financiare, kënaqësia e klientit, produktiviteti i punonjësve ose efikasiteti operacional, ose buxhetor / financiar dhe për të përcaktuar nëse synimet ose objektivat po përmbushen. Treguesit e performancës përdoren shpesh në sektorin privat por edhe ate publik dhe organizata të tjera për të ndihmuar menaxherët të marrin vendime të informuara, të identifikojnë fushat e përmirësimit dhe të masin performancën e përgjithshme tw bashkisw.

Të Dhëna

Janë informacionet e mbledhura nga burime zyrtare të bashkisë ose institucione të tjera, që shërbejnë si bazë për llogaritjen e treguesve të performancës. Të dhënat mund të jenë numerike (statistika mbi popullsinë, buxhetin, shkollat etj.) ose cilësore (planifikime, raporte, dokumente strategjike) dhe janë të domosdoshme për analizën dhe raportimin e performancës.

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Taksat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti i kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për cfarëdo zë apo projekt).

Si të lexojmë tabelën e performancës

Tabelat e treguesve në çdo fushë paraqesin ecurinë e treguesve të performancës për secilën fushë funksionale. Për çdo tregues jepen vlerat për dy vite, ndryshimi ndërvite, trendi, dhe semafori, të cilat ndihmojnë në interpretimin e rezultateve.

Kolona	Përshkrimi
Treguesi	Emri i treguesit që mat një aspekt të caktuar të performancës (p.sh. "Përqindja e konsultimeve publike të zhvilluara").
Njësia matëse	Tregon mënyrën se si matet treguesi (p.sh. %, numër, ha, lekë/frymë).
Vlera 2024 / 2025	Tregojnë rezultatet e arritura për secilin vit.
Ndryshimi (%)	Diferenca në përqindje ndërmjet viteve. Formula: $(\text{Vlera 2025} - \text{Vlera 2024}) / \text{Vlera 2024} \times 100$.
Trendi dhe Simboli i Trendit (→ ↑ ↓)	Diferenca në vlerë absolute ndërmjet viteve. (Vlera 2025 – Vlera 2024). Simboli i Trendit tregon drejtimin e lëvizjes: ↑ përmirësim, ↓ përkeqësim, → stabilitet
Semafori	Vlerësim vizual i nivelit të performancës: □ = vlerë absolute ndryshimi pozitiv ● = vlerë absolute ndryshimi negative.

Nota metodologjike mbi semaforin dhe interpretimin e treguesve

Në tabelat e performancës, ngjyra e semaforit llogaritet automatikisht sipas parimit të përgjithshëm "vlera positive ndryshimi = jeshile". Kjo rregull zbatohet njëtrajtësisht për të gjithë treguesit dhe mund të japë vizualisht ngjyrë të kuqe edhe në raste kur rezultati real është pozitiv.

Në veçanti, për disa tregues me logjikë të përmbysur, ulja e vlerës absolute përfaqëson përmirësim të performancës. Këtu përfshihen, ndër të tjera:

- Detyrimet e prapambetura (rënia tregon përmirësim financiar).
- Shpenzimet administrative (ulja tregon efikasitet).

QELLIMI I RAPORTIT

Raporti i Performancës 2026 synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi performancën e bashkisë në 15 fusha funksionale. Ky raport përdoret për të ndihmuar vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien, si dhe për të mundësuar krahasimin ndërmjet bashkive në nivel kombëtar.

Ky raport është përgatitur nga Bashkia e Pustecit, i mandatuar nga Kryetari i Bashkisë në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, Neni 33, si dhe në kuadër të Sistemit Kombëtar të Matjes së Performancës (SMP 2025).

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI BASHKINË

Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë e Pustecit

Bashkia e Pustecit bën pjesë në qarkun e Korçës dhe ndodhet në pjesën verilindore të tij, përgjatë brigjeve të liqenit të Prespës. Kryeqendra e bashkisë është fshati Pustec, i cili ndodhet rreth 25 km larg qytetit të Korçës. Bashkia përbëhet nga një njësi administrative që përfshin nëntë fshatra: Pustec, Shulin, Leska, Zaroshka, Cerje, Goricë e Madhe, Goricë e Vogël, Diellas dhe Gollomboc. Territori i bashkisë shtrihet në një sipërfaqe prej **198km²**, me një popullsi prej **1,843 banorësh** dhe një **dendësi mesatare prej rreth 9 banorë për km²**.

Popullsia e bashkisë përbëhet kryesisht nga minoriteti etnik maqedonas, i cili është i integruar në jetën ekonomike, sociale dhe politike të vendit, duke përfaqësuar një model të bashkëjetesës kulturore dhe ndërkufitare. Pozicioni gjeografik i Pustecit, pranë kufirit me Maqedoninë e Veriut dhe në zemër të zonës së mbrojtur të Prespës, e bën atë një territor me vlera të veçanta natyrore, ekologjike dhe turistike.

Bashkia drejtohet aktualisht nga Kryetari **Z. Pali Kolefski** në mandatin e tij të dytë, dhe synon të zhvillojë një qeverisje të përgjegjshme, transparente dhe të orientuar drejt qytetarëve.

Qëllimi dhe Objektivat Strategjike

Qëllimi kryesor i bashkisë është të sigurojë qeverisje efikase dhe shërbime cilësore për qytetarët, përmes një administrate të përkushtuar dhe planifikimi të qëndrueshëm. Objektivat strategjike përfshijnë:

- **Rritjen e zhvillimit ekonomik lokal**, nëpërmjet nxitjes së agroturizmit dhe turizmit të qëndrueshëm kulturor e natyror;
- **Përmirësimin e infrastrukturës rrugore, ujësjellësit dhe kanalizimeve**, për të lehtësuar lëvizjen dhe kushtet e jetesës;
- **Mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë natyrore e kulturore** të zonës së Prespës;
- **Rritjen e cilësisë së shërbimeve publike** dhe forcimin e kapaciteteve administrative të bashkisë.

Përmbledhje e situatës dhe sfidave të zhvillimit

Pozicionimi i Bashkisë Pustec brenda zonës së mbrojtur të Parkut Kombëtar të Prespës paraqet një realitet unik, ku zhvillimi ekonomik duhet të ecë paralelisht me mbrojtjen e ekosistemit natyror. Ky status sjell përgjegjësi shtesë për bashkinë në planifikimin dhe menaxhimin e shërbimeve publike, pasi çdo ndërhyrje infrastrukturore, bujqësore apo turistike kërkon një **përqaasje të kujdesshme dhe të qëndrueshme**, në përputhje me rregullat e ruajtjes së mjedisit.

Në këtë kontekst, **resurset e kufizuara njerëzore dhe financiare** përbëjnë një pengesë të rëndësishme për zbatimin e plotë të planeve të zhvillimit dhe mirëmbajtjes së shërbimeve. Distanca e mëdha ndërmjet fshatrave, mungesa e infrastrukturës moderne dhe nevoja për koordinim me institucionet mjedisore kombëtare e rajonale e bëjnë menaxhimin e përditshëm më kompleks se në bashki të tjera.

Megjithatë, ky kufizim mund të kthehet në mundësi për **zhvillim të gjelbër**, përmes promovimit të turizmit natyror, bujqësisë organike dhe përdorimit të energjive të rinovueshme, që ruajnë karakterin e zonës dhe rrisin mirëqenien e komunitetit pa dëmtuar ekosistemin e ndjeshëm të Prespës.

Sfidat kryesore

Megjithatë, bashkia përballlet me disa sfida të theksuara:

- **Migracioni i lartë dhe plakja e popullsisë**, që ndikojnë në fuqinë punëtore dhe qëndrueshmërinë demografike;
- **Mungesa e diversifikimit ekonomik**, me varësi të madhe nga bujqësia tradicionale dhe ndihma sociale;
- **Vështirësitë infrastrukturore**, sidomos në rrugët lidhëse ndërmjet fshatrave dhe në aksesin e shërbimeve publike;
- **Kapacitete të kufizuara administrative dhe teknike**, që kufizojnë përdorimin efektiv të fondeve të BE-së dhe pjesëmarrjen në projekte ndërkufitare;

- **Ndikimet mjedisore** në liqenin e Prespës, që kërkojnë menaxhim të kujdesshëm dhe bashkërendim rajonal.

Mundësitë dhe potencialet

Pusteci zotëron një sërë mundësish zhvillimi që mund të shfrytëzohen në vitet në vijim:

- **Turizmi i qëndrueshëm dhe ekologjik**, bazuar në resurset e Parkut Kombëtar të Prespës dhe traditat lokale;
- **Zhvillimi i bujqësisë organike dhe agroturizmit**, duke përfituar nga terreni dhe produktet vendore me cilësi të lartë;
- **Përfshirja në programet e BE-së dhe IPA**, në fushat e mjedisit, turizmit të qëndrueshëm, energjisë së gjelbër dhe digjitalizimit;
- **Bashkëpunimi ndërkufitar me bashki homologe në Maqedoninë e Veriut dhe Greqi**, për zhvillim të përbashkët ekonomik e kulturor.

TË DHËNAT E PËRGGJITHSHME TË BASHKISË

E DHËNA	Viti 2025
Popullësia totale nën administrimin e bashkisë	1843
Sipërfaqja totale e bashkisë (në km ²)	198.68
Sipërfaqe publike e bashkisë në km ²	2km ²
Sipërfaqja e njësive administrative në total	198.68
Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullosor (në ha)	457.6
Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)	1,363.8
Numri total i njësive administrative të bashkisë	1

Numri i fshatrave	9
Punonjës të bashkisë në total	92
Numri total i punonjësve femra të bashkisë	33
Numri total i punonjësve meshkuj të bashkisë	59
Numri total i punonjësve që punojnë për administratën e bashkisë	36

SHERBIME PUBLIKE VENDORE

Shërbimi: Rrjeti rrugor

Analiza e performancës

Shërbimi i mirëmbajtjes së rrjetit rrugor në Bashkinë Pustec paraqet një situatë stabile në aspektin operacional, por me sinjale për përmirësim në eficiencën financiare.

Treguesit kryesorë të shërbimit rezultojnë pa ndryshime ndërmjet viteve, ku:

- 100% e popullsisë mbetet e mbuluar nga rrjeti rrugor
- 43 km rrjet rrugor vijon të mirëmbahen çdo vit
- vetëm 11.63% e rrjetit është e pajisur me sinjalistikë

Kjo tregon për një nivel bazik funksionimi, por jo për zhvillim apo përmirësim të cilësisë së shërbimit.

Nga ana tjetër, evidentohet një ulje e ndjeshme e shpenzimit për km rrjet rrugor (-20.27%), e cila mund të interpretohet në dy mënyra:

- pozitivisht: si rritje e eficiencës së përdorimit të burimeve
- negativisht: si reduktim i investimeve dhe mirëmbajtjes reale

Në mungesë të përmirësimeve në tregues cilësorë (si sinjalistika apo zgjerimi i rrjetit), kjo ulje sugjeron më shumë një tkurrje të shpenzimeve sesa optimizim real.

Konkluzion:

Shërbimi është funksional dhe i qëndrueshëm, por nuk po përmirësohet, duke reflektuar kufizime financiare dhe mungesë investimesh zhvilluese.

Treguesit Permbledhes

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Përqindja e rrjetit rrugor të shtruar	%	0.00	0.00	0.00		0.00%	○
Tregues	Përqindja e rrjetit me sinjalistikë	%	11.63	11.63	0.00	→	0.00%	⊠
Tregues	Gjatësia e rrjetit rrugor të mirëmbajtur në vit	km	43.00	43.00	0.00	→	0.00%	⊠
Tregues	Shpenzim për km rrjet rrugor	Mije Leke/km	10211.86	8141.70	-2070.16	↓	-20.27%	⊠
Nëntregues	Gjatësia e mirëmbajtur – Urban	km	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	⊠
Nëntregues	Gjatësia e mirëmbajtur – Rural	km	43.00	43.00	0.00	→	0.00%	⊠
Nëntregues	Gjatësia e mirëmbajtur – Urban	km	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	⊠
Nëntregues	Gjatësia e mirëmbajtur – Rural	km	43.00	43.00	0.00	→	0.00%	⊠

Tregues	Popullsia e mbuluar nga rrjeti rrugor	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	□
---------	---------------------------------------	---	--------	--------	------	---	-------	---

Të dhënat burim për këtë shërbim

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
DSRR01	Gjatësia e rrjetit rrugor te shtruar	15,45	15,45	15,46	Km
DSRR02	Gjatësia totale e rrjetit rrugor	43	43	43	Km
DSRR03	Rrjet rrugor me sinjalistikë	5	5	5	Km
DSRR04	Rrjet rrugor i mirëmbajtur	43	43	43	Km
DSRR05	Shpenzime per rrjetin rrugor	1720489	439110	350093	Lekë
DSRR06	Popullsi e mbuluar me rrjet rrugor	3831	1843	1843	numër
D57	Popullsia totale e bashkise	3831	1843	1843	numër

Shërbimi: Ndrçimi public

Analiza e performancës

Shërbimi i ndriçimit publik paraqet një nga performancat më pozitive në raport, me përmirësime të dukshme në disa tregues kyç.

- Shpenzimet për ndriçim janë rritur me 65.5%

- Të ardhurat nga tarifa janë rritur me 13.5%
- Mbulesa e sipërfaqes publike është rritur nga 26.98% në 30.33%

Këto zhvillime tregojnë një zgjerim të shërbimit dhe rritje të investimeve, duke reflektuar prioritet të bashkisë në këtë sektor.

Megjithatë:

- numri i pikave të ndriçimit mbetet i pandryshuar
- rrjeti i mirëmbajtur nuk është zgjeruar

Kjo sugjeron se rritja e mbulimit ka ardhur kryesisht nga optimizimi i përdorimit të infrastrukturës ekzistuese, jo nga investime në zgjerim fizik.

Konkluzion:

Shërbimi është në **fazë përmirësimi dhe konsolidimi**, me progres real në akses dhe financim, por kërkon investime të mëtejshme për zgjerim strukturor

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Gjatësia e rrjetit të ndriçimit të mirëmbajtur	km	16.70	16.70	0.00	→	0.00%	?
Tregues	Shpenzime për ndriçimin publik	Mijë Lekë	857963.00	1420256.00	562293.00	↑	65.54%	?
Tregues	Të ardhura nga tarifa e ndriçimit	Mijë Lekë	336047.00	381464.00	45417.00	↑	13.52%	?
Tregues	% e sipërfaqes publike të mbuluar me ndriçim	%	26.98	30.33	3.35	↑	12.41%	?

Tregues	Numri i pikave të ndriçimit funksionale	numër	21.00	21.00	0.00	→	0.00%	?
Nëntregues	Gjatësia e mirëmbajtur – Urban	km	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	?
Nëntregues	Gjatësia e mirëmbajtur – Rural	km	16.70	16.70	0.00	→	0.00%	?
Nëntregues	Gjatësia e mirëmbajtur – Urban	km	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	?
Nëntregues	Gjatësia e mirëmbajtur – Rural	km	16.70	16.70	0.00	→	0.00%	?

Të dhënat burim për këtë shërbim

Kodi I të dhënës	Kodi i Treguesit	Përdorur në treguesit	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
DSNP01	NP01	NP01	Gjatësia e rrjetit të ndriçimit të mirëmbajtur	15.5	16.7	16.7	Km
DSNP02	NP02	NP02	Shpenzime per shërbimin e ndriçimit	728728	857963	1420256	Lekë
DSNP03	NP03	NP03	Të ardhura nga taksa e ndriçimit	383530	336047	381464	Lekë
DSNP04	NP04	NP04	Sipërfaqe totale	48.5	58	65.2	Km ²

			publike e ndriçuar				
DSNP05	NP04	NP04	Sipërfaqe publike totale	215	215	215	Km ²
DSNP06	NP05	NP05	Numri I pikave te ndriçimit funksional	21	21	21	numër

Shërbimi: Gjelbërimi i sipërfaqeve publike

Analiza e performancës

Shërbimi i gjelbërimit karakterizohet nga stabilitet operacional, por me nivel shumë të ulët zhvillimi strukturor.

- Sipërfaqja e gjelbër për frymë 1.09 m²/banor
- 100% e sipërfaqes ekzistuese mirëmbahen
- rritje e shpenzimeve për gjelbërim (+6.9%)
- rritje e numrit të pemëve të mbjella (+30%)

Megjithatë, investimet janë ende të pamjaftueshme për të ndryshuar strukturën e shërbimit.

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Sipërfaqe e gjelbër publike për frymë	m ² /banor	1.09	1.09	0.00	→	0.00%	🟡
Tregues	Sipërfaqja publike e	%	0.93	0.93	0.00	→	0.00%	🟡

	mbuluar me gjelbërim							
Tregues	Shkalla e mirëmbajtjes e sipërfaqes te gjelbër publike gjatë vitit	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	?
Tregues	Shpenzim për m ² gjelbërim publik	mije Lekë/m ²	46.75	50.00	3.25	↑	6.95%	?
Tregues	Numri i pemëve të mbjella gjatë vitit	numër	100.00	130.00	30.00	↑	30.00%	?
Nëntregues	m ² gjelbërim publik për frymë – Urban	m ² /banor				↓		?
Nëntregues	m ² gjelbërim publik për frymë – Rural	m ² /banor	1.09	1.09	0.00	→	0.00%	?
Nëntregues	Sipërfaqja publike urbane e mbuluar me gjelbërim	%				↓		?
Nëntregues	Sipërfaqja publike rurale e mbuluar me gjelbërim	%	0.01	0.01	0.00	→	0.00%	?

Të dhënat burim për këtë shërbim

Kodi I të dhënës	Kodi i Treguesit	Përdorur në treguesit	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D57	RR05	RR05, GJ01	Popullsia totale e bashkise	3831	1843	1843	numër
DSGJ01	GJ01	GJ01, GJ02, GJ03, GJ04	Sipërfaqe e gjelbër publike (rurale + urbane)	2000	2000	2000	m ²
DSGJ03	GJ02	GJ02	Sipërfaqe totale publike e bashkise	215000	215000	215000	m ²
DSGJ04	GJ03	GJ03	Sipërfaqe publike (urbane dhe rurale) e mirëmbajtur me gjelberim gjatë vitit	2000	2000	2000	m ²
DSGJ05	GJ04	GJ04	Shpenzime totale për gjelbërim	0	93500	100000	Lekë
DSGJ06	GJ05	GJ05	Numri i pemëve të mbjella	100	100	130	Nr

Shërbimi: Mirembajtja e Varrezave

Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave paraqet një performancë shumë të mirë në aspektin operacional.

- 100% e varrezave mirëmbahen sipas planit
- kapaciteti i lirë është rritur ndjeshëm (nga 11% në 20%)

- të ardhurat janë rritur me 33.8%

Rritja e kapacitetit lidhet me zgjerim të hapësirave ose menaxhim më të mirë të kapaciteteve ekzistuese

Nga ana tjetër, mungesa e të dhënave për disa tregues operacionalë (p.sh. koha e përpunimit) tregon për nevojë për përmirësim në raportim dhe DQA.

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	% varresh me mirëmbajtje sipas planit	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	🟡
Tregues	Kapacitet i lirë i varrezave	%	11.11	20.00	8.89	↑	80.00%	🟡
Tregues	Të ardhura nga tarifat e varrezave	Lekë	13900.00	18600.00	4700.00	↑	33.81%	🟡

Të dhënat burim për këtë shërbim

Kodi I të dhënës	Kodi i Treguesit	Përdorur në treguesit	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
DSVR01	VR01	VR01	Njësi/zonë e mirëmbajtur sipas planit	9	9	9	numër
DSVR02	VR01	VR01	Njësi/zonë totale për mirëmbajtje	9	9	9	numër
DSVR03	VR02	VR02	Vende/parcelë të lira	1	1	2	numër
DSVR04	VR02	VR02	Kapacitet total (vende/parcelë)	9	9	10	numër

DSVR05	VR03	VR03	Totali i ditëve të përpunimit (sum)	0	0	0	ditë
DSVR06	VR03	VR03	Numri i kërkesave të përpunuara	0	0	0	Nr
DSVR07	VR04	VR04	Shpenzime totale për varreza	0	0	330000	Lekë
DSVR08	VR04	VR04	Numri i varreve aktive	0	0	0	numër
DSVR09	VR05	VR05	Të ardhura nga tarifat	0	13900	18600	Lekë

SHËRBIMI I KULTURËS

Analiza e performancës

Shërbimi i kulturës paraqet një rritje të dukshme në aktivitetet dhe pjesëmarrje, duke reflektuar një angazhim më të madh të bashkisë në jetën kulturore.

- Aktivitetet kulturore janë rritur me ~28%
- Pjesëmarrja është rritur me ~17%
- Shpenzimet për banor janë dyfishuar

Megjithatë:

- vetëm ~60% e objekteve kulturore janë funksionale
- nuk ka të ardhura nga aktivitetet

Kjo sugjeron aktivitet i rritur, por me bazë infrastrukturore të kufizuar dhe pa qëndrueshmëri financiare

Konkluzion:

Shërbimi është në zgjerim dhe aktivizim, por kërkon:

- investime në infrastrukturë

- modele të gjenerimit të të ardhurave

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Numri i aktiviteteve kulturore për 1,000 banorë	Nr/1000 banorë	3.80	4.88	1.09	↑	28.57%	🟢
Tregues	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete kulturore për 1,000 banorë	Nr/1000	922.41	1085.19	162.78	↑	17.65%	🟢
Tregues	% objekteve kulturore funksionale	%	60.61	60.61	0.00	→	0.00%	🟡
Tregues	Shpenzim për banor për kulturë	mije Lekë/banor	0.38	0.74	0.37	↑	97.26%	🟢
Tregues	Të ardhura nga aktivitetet kulturore	Mije Lekë	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	🟡

Të dhënat burim për këtë shërbim

Kodi I të dhënës	Kodi i Treguesit	Përdorur në treguesit	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D57	RR05	RR05, GJ01	Popullsia totale e bashkise	3831	1843	1843	numër

DSKU01	KU01	KU01	Numri total i aktiviteteve kulturore	7	7	9	numër
DSKU03	KU02	KU02	Numri total i pjesëmarrësve	1600	1700	2000	numër
DSKU04	KU03	KU03	Objekte kulturore funksionale	20	20	20	numër
DSKU05	KU03	KU03	Objekte kulturore totale	33	33	33	numër
DSKU06	KU04	KU04	Shpenzime totale për kulturë	274	693	1367	Mije Lekë
DSKU07	KU05	KU05	Të ardhura nga aktivitetet	0	0	0	Mije Lekë

Shërbimi: Sport & Argëtim

Shërbimi i sportit dhe argëtimit në Bashkinë Pustec paraqet një stabilitet në nivel aktiviteti, me 1.09 aktivitete sportive për 1,000 banorë pa ndryshim ndërvite. Megjithatë, evidentohet një rritje e pjesëmarrjes, nga 75.96 në 86.81 pjesëmarrës për 1,000 banorë (+14.29%), që tregon një interes në rritje të komunitetit për aktivitetet sportive.

Nga ana tjetër, infrastruktura dhe kapacitetet mbeten të pandryshuara: vetëm 66.67% e objekteve sportive janë funksionale dhe sipërfaqja sportive për frymë mbetet konstante (6.12 m²/banor). Rritja e lehtë e shpenzimeve për banor (+9.89%) nuk ka sjellë zgjerim të shërbimit, duke sugjeruar se përmirësimi lidhet më shumë me përdorimin më të mirë të kapaciteteve ekzistuese sesa me investime të reja.

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
------	------	---------------	-----------------------	---------------------	--------	---------	-------------	---------

Tregues	Numri i aktiviteteve sportive për 1,000 banorë	Nr/1000	1.09	1.09	0.00	→	0.00%	?
Tregues	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete sportive për 1,000 banorë	Nr/1000	75.96	86.81	10.85	↑	14.29%	?
Tregues	% objekteve sportive funksionale	%	66.67	66.67	0.00	→	0.00%	?
Tregues	Shpenzim për banor për sport & argëtim	Lekë/banor	0.10	0.11	0.01	↑	9.89%	?
Tregues	Sipërfaqe sportive publike për frymë	m ² /banor	6.12	6.12	0.00	→	0.00%	?

Të dhënat burim për këtë shërbim

Kodi I të dhënës	Kodi i Treguesit	Përdorur në treguesit	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D57	RR05	RR05, GJ01	Popullsia totale e bashkise	3831	1843	1843	numër
DSSP01	SP01	SP01	Numri total i aktiviteteve sportive	2	2	2	numër
DSSP03	SP02	SP02	Numri total i pjesëmarrësve	150	140	160	numër

DSSP04	SP03	SP03	Objekte sportive funksionale	2	2	2	numër
DSSP05	SP03	SP03	Objekte sportive totale	3	3	3	numër
DSSP06	SP04	SP04	Shpenzime totale për sport	100	182	200	Mije Lekë
DSSP07	SP05	SP05	Sipërfaqe sportive publike	11285	11285	11285	m ²



ARSIMI PARANIVERSITAR

Analiza e performancës

Shërbimi i arsimit parauniversitar në Bashkinë Pustec paraqet një situatë të qëndrueshme në aspektin e mirëmbajtjes së infrastrukturës, por me sinjale të qarta për tkurrje të popullsisë shkollore. Treguesit kryesorë të mirëmbajtjes mbeten në nivel optimal (100% e kopshteve dhe shkollave 9-vjeçare të mirëmbajtura), ndërkohë që investimet për institucion janë rritur ndjeshëm (+27.85%), duke reflektuar një përpjekje për të ruajtur cilësinë e shërbimit.

Megjithatë, evidentohet një rënie e fortë në treguesit e ngarkesës së sistemit arsimor, ku numri mesatar i fëmijëve në kopshte ka rënë nga 4.20 në 2.40 (-42.86%), ndërsa raporti nxënës/mësues dhe madhësia e klasave në arsimin bazë kanë rënë me rreth -9%. Në të njëjtën kohë, numri i godinave arsimore është reduktuar (-12.5%), duke reflektuar drejtpërdrejt efektet e migracionit dhe rënies demografike.

Nga ana tjetër, shërbimi paraqet edhe disa zhvillime pozitive strukturore, si miratimi i Planit Vendor të Arsimit dhe rritja e numrit mesatar të nxënësve në arsimin e mesëm (+15.38%), që sugjerojnë një konsolidim të pjesshëm të këtij niveli arsimor. Megjithatë, në tërësi, sistemi po përballet me sfidën e nën-përdorimit të kapaciteteve, duke e orientuar shërbimin më shumë drejt menaxhimit të tkurrjes sesa zhvillimit.

A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trend i	Simbo l	% Ndryshimi	Semaf or
Tregues	Kopshteve të mirëmbajtura kundrejt numrit total të kopshteve pubike	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	□
Tregues	Shkolla 9 vjeçare të mirëmbajtura, kundrejt numrit total të shkollave 9 vjeçare publike	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	□
Tregues	Raporti nxënës/mësues në shkolla 9 vjeçare	nxënës/mësues	4.00	3.64	-0.36	↓	- 8.93%	●
Tregues	Numri mesatar i nxënësve në një klasë të shkollës 9 vjeçare publike	nxënës/klasë	3.50	3.19	-0.31	↓	- 8.93%	●
Tregues	Numri mesatar i fëmijëve në një klasë kopshti publik	nxënës/klasë	4.20	2.40	-1.80	↓	- 42.86%	●
Tregues	Punonjës mbështetës për shkollë 9 vjeçare	punonjës mbështetës/shkollë 9 vjeçare	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	□
Tregues	Shkolla 9 vjeçare të rikonstruara	numër	3.00	3.00	0.00	→	0.00%	□
Tregues	Kopshte të rikonstruara	numër	4.00	4.00	0.00	→	0.00%	□
Tregues	Raporti i shpenzimeve për institucionet e arsimit parauniversitar kundrejt numrit total të institucioneve (Mijë Lekë/institucion)	Mijë Lekë/institucion	1095.25	1400.29	305.04	↑	27.85%	□

Tregues	Kopshte ku jane ngritur keshillat e prinderve kundrejt numrit total te kopshteve publike	%	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	□
Tregues	Punonjës mbështetës për shkollë mesme të përgjithshme	punonjës mbështetës/shkolle e mesme	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	□
Tregues	Numri mesatar i nxënësve në një klasë të arsimit të mesëm të përgjithshëm publik	nxënës/klasë	4.33	5.00	0.67	↑	15.38 %	□
Tregues	Numri i konvikteve funksionale	numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	□
Tregues	Numri i prinderve te informuar ne lidhje me prinderimin pozitiv per femijet 0-3 vjec	numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	□
Tregues	Shkalla e regjistrimit në çerdhe publike	nxënës/mësues	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	□
Tregues	Shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	□
Tregues	Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar	Po/Jo	0.00	0.00	1.00	↑	100.00%	□
Tregues	Godina Arsimore sipas nivelit arsimor	numër	8.00	7.00	-1.00	↓	-12.50 %	●
Nëntregues	Godina Arsimore publike sipas nivelit arsimor	numër	8.00	7.00	-1.00	↓	-12.50 %	●

Nëntregues	Godina Arsimore private sipas nivelit arsimor	numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	□
------------	---	-------	------	------	------	---	-------	---

C) Shtojcë: Të dhënat burim

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D01	Numri I çerdheve publike të mirëmbajtuara	0	0	0	Numër
D02	Numri I kopshteve publike të mirëmbajtuara	6	5	4	Numër
D03	Numri I shkollave 9 vjeçare publike të mirëmbajtuara	2	2	2	Numër
D04	Numri I nxënësve të regjistruar në shkolla 9 vjeçare publike	89	56	51	Numër
D05	Numri I mësuesve që japin mësim në shkolla 9 vjeçare publike	14	14	14	Numër
D06	Numri I klasave të kopshteve publike	5	5	5	Numër
D07	Numri I klasave të shkollave 9 vjeçare publike	16	16	16	Numër
D08	Numri i ndërtesave publike të arsimit bazë të rikonstruara	3	3	3	Numër
D09	Numri i ndërtesave publike të arsimit parashkollor të rikonstruara	4	4	4	Numër
D10	Numri i stafit mbështetës në arsimin bazë në shkollat 9 vjeçare publike	2	2	2	Numër
D11	Shpenzime për insitucione publike të arsimit parauniversitar: çerdhe,	8970	8762	9802	Mijë Lekë

	kopshte, shkolla 9 vjeçare, shkolla të mesme të përgjithshme				
D12	Numri i kopshteve publike ku janë ngritur këshillat e prindërve	0	0	0	Numër
D13	Numri i stafit mbështetës në shkolla të mesme të përgjithshme publike	1	1	1	Numër
D14	Totali i shpenzimeve (Operative dhe mirëmbajtje si edhe investime) për konviktet e arsimit profesional	0	0	0	Mijë Lekë
D15	Numrit total të studentëve të akomoduar në konvikte të arsimit profesional	0	0	0	Numër
D16	Numri i nxënësve të regjistruar në shkolla të mesme të përgjithshme publike	15	13	15	Numër
D17	Numri i klasave në shkolla të mesme të përgjithshme publike	3	3	3	Numër
D18	Numri i nxënësve të akomoduar në konvikte të arsimit profesional	0	0	0	Numër
D19	Numri i dhomave të konvikteve të arsimit profesional	0	0	0	Numër
D20	Numri i konvikteve funksionale	0	0	0	Numër
D21	Numri i prindërve të informuar në lidhje me prindërimin pozitiv për fëmijet 0-3 vjeç	0	0	0	Numër
D22	Numri i personelit të çerdheve publike	0	0	0	Numër

D23	Numri i personelit të trainuar të çerdheve publike	0	0	0	Numër
D24	Numri i çerdheve publike të furnizuara me material didaktik	0	0	0	Numër
D25	Numri i fëmijëve të moshës nga 6 muaj-3 vjeç në bashki	23	25	24	Numër
D26	Numri i fëmijëve të moshës 6 muaj deri në 3 vjeç të regjistruar në çerdhe publike	0	0	0	Numër
D27	Numri i fëmijëve të moshës nga 3–6 vjeç në bashki	29	21	12	Numër
D28	Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet publike	29	21	12	Numër
D29	Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet private	0	0	0	Numër
D30	Numri i edukatorëve në kopshte publike	7	7	7	Numër
D31	Numri i edukatorëve në kopshte private	0	0	0	Numër
D32	Numri i çerdheve publike në bashki	0	0	0	Numër
D33	Numri i çerdheve private në bashki	0	0	0	Numër
D34	Numri i kopshteve publike në bashki	6	5	4	Numër
D35	Numri i kopshteve private në bashki	0	0	0	Numër
D36	Numri i shkollave 9-vjeçare publike në bashki	2	2	2	Numër

D37	Numri i shkollave 9-vjeçare private në bashki	0	0	0	Numër
D38	Numri i shkollave të mesme të përgjithshme publike në bashki	1	1	1	Numër
D39	Numri i shkollave të mesme të përgjithshme private në bashki	0	0	0	Numër
D40	Plani vendor i Arsimit Parauniversitar, I miratuar ose zbatuar	jo	jo	po	Po/Jo



MENAXHIMI I MBETJEVE

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve paraqet një **stabilitet në mbulim**, me 94.44% të popullsisë të mbuluar pa ndryshim ndërvite. Megjithatë, evidentohet një rritje e mbetjeve për frymë nga 58.60 në 65.04 kg/banor (+10.98%), që kërkon vëmendje në aspektin e menaxhimit të volumit.

Nga ana tjetër, situata financiare është përkeqësuar, pasi mbulimi i kostos nga tarifat ka rënë nga 21.49% në 16.75% (-22.04%). Kjo tregon një rritje të varësisë nga burime të tjera financimi dhe një dobësim të qëndrueshmërisë financiare të shërbimit, pavarësisht ekzistencës së planit vendor të menaxhimit të mbetjeve.

B) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semaf or
Tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale	%	94.44	94.44	0.00	→	0.00%	?

Tregues	Mbetjet e gjeneruara si kg/banor	kg/banor	58.60	65.04	6.44	↑	10.98 %	?
Tregues	Mbulimi kosos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit	%	21.49	16.75	-4.74	↓	- 22.04 %	?
Tregues	Plani vendor I menaxhimit të mbetjeve I miratuar ose në zbatim	Numër	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	?
Nëntregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	?
Nëntregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat rurale	%	88.89	88.89	0.00	→	0.00%	?

C) Shtojcë: Të dhënat burim

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D54	Numri njësive administrative qendër (qytete) të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	1	1	1	Numër
D55	Numri njësive administrative qendër (qytete) të bashkisë	1	1	1	Numër
D56	Numri fshtrave të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	8	8	8	Numër
D57	Numri fshatrave në territorin e bashkise	9	9	9	Numër
D58	Sasia e mbetjeve të gjeneruara gjithsej	72000	108000	119860	Kg
D59	Të ardhurat gjithsej nga tarifa e shërbimit të mbetjeve	959.69	924	1005	mijë Lekë

D60	Shpenzime gjithsej për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve	3602.47	4300	5999	mijë Lekë
D61	Plani i miratuar ose zbatuar gjatë vitit të raportimit	1	1	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)
D52	Popullsia e përgjithshme e bashkisë	3831	1843	1843	Numër



MBROJTJA NGA ZJARRI

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri tregon një përmirësim të moderuar në kapacitetet njerëzore, ku numri i zjarrfikësve për 1,500 banorë është rritur nga 10.58 në 11.39 (+7.69%). Kjo reflekton një përfundim gradual të kapacitetit operacional të shërbimit.

Ndërkohë, kapacitetet teknike mbeten të pandryshuara, me 5.43 automjete zjarrfikëse për 10,000 banorë pa ndryshim ndërvite. Ky kombinim tregon se përmirësimi është i kufizuar vetëm në burimet njerëzore, ndërsa mungesa e investimeve në pajisje mund të kufizojë efektivitetin e përgjithshëm të shërbimit në situata emergjente.

B) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semaf or
------	------	---------------	-----------------------	---------------------	--------	--------	-------------	----------

Tregues	Zjarrëfikës për 1,500 banorë	punonjës/ 1500 banorë	10.58	11.39	0.81	↑	7.69%	?
Tregues	Automjete zjarrëfikëse për 10,000 banorë	mjete/10 000 banorë	5.43	5.43	0.00	→	0.00%	?
Nëntregues			0.00	0.00	0.00		0.00%	○

C) Shtojcë: Të dhënat burim

Kodi I të dhënës	Kodi i Treguesit	Përdorur në treguesit	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D51	292A01	292A01	Numri i punonjësve zjarrëfikës në bashki	12	13	14	Numër
D52	292A01	292A02, 292A01	Popullsia e përgjithshme e bashkisë	3831	1843	1843	Numër
D53	292A02	292A02	Numri i mjeteve zjarrëfikëse funksionale në bashki	1	1	1	Numër
D50	275A03	275A03	Numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor	7	7	8	Numër

MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

Shërbimi i ujitjes dhe kullimit paraqet një stagnim në mbulim, ku 73.32% e tokës bujqësore mbetet e pajisur me kanale pa ndryshim. Megjithatë, evidentohet një përkeqësim në funksionalitetin e rrjetit, me rënie të kanaleve funksionale nga 45.71% në 42.86% (-6.25%).

Ky përkeqësim lidhet kryesisht me kanalet kulluese, ku funksionaliteti ka rënë nga 91.43% në 85.71%, ndërkohë që kanalet ujitëse rezultojnë jo funksionale (0%). Kjo tregon se, pavarësisht mbulimit relativisht të lartë, cilësia dhe funksionaliteti i infrastrukturës po dobësohen, duke ndikuar negativisht në eficiencën e shërbimit.

B) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semaf or
Tregues	Tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje/kullimi	%	73.32	73.32	0.00	→	0.00%	?
Tregues	Përqindja e kanaleve ujitëse dhe kulluese funksionale	%	45.71	42.86	-2.86	↓	-6.25%	?
Nëntregues	Përqindja e kanaleve ujitëse funksionale	%	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	?
Nëntregues	Përqindja e kanaleve kulluese funksionale	%	91.43	85.71	-5.71	↓	-6.25%	?

C) Shtojcë: Të dhënat burim

Kodi I të dhënës	Kodi i Treguesit	Përdorur në treguesit	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
